



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 27 datë 4.4.2023

PËR

“MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. SAIMIR LAQJA, ZNJ. MRI MARKU, Z. PJETËR MHILLAJ DHE Z. NIKOLIN GOJÇAJ BANESAT E TË CILËVE U JANË DËMTUAR NGA ZJARRI.

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 4.4.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar;; Ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“; VKM-së nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”; Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKB-së Nr 71 datë 27.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës” ; Shkresës me Nr. 3950 Prot., datë 21.06.2017 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në Relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. Saimir Laqja (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njqind mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Saimir Laqja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 292 122 (dyqind e nentëdhjete e dymije e njeqind e njezet e dy) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 254 400 (dyqind e pesëdhjete e katërmije e katërqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Saimir Laqja** .
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së **znj. Mri Marku** (1 anëtarë familje), në vlerën prej 20 000 (njezet mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . **znj. Mri Marku** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 26 250 (njezet e gjashtëmije e dyqind e pesëdhjete) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 68 600 (gjashtëdhjetë e tetë mije e gjashtëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **znj. Mri Marku** .
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Pjetër Mhillaj** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 (dyzet mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Pjetër Mhillaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 1 375 601 (njemilion e treqind e shtatëdhjete e pesëmije e gjashtëqind e nje) leke dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 508 180 (peseqind e tetëmije e njeqind e tetëdhjete) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Pjetër Mhillaj** .
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z. **Nikolin Gojçi** (3 anëtarë familje), në vlerën prej 60 000 (gjashtëdhjete mijë) lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e . z. **Nikolin Gojçi** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 304 195 (treqind e katërmije e njeqind e nentëdhjete e pese) leke dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 327 800 (treqind e njezet e shtatëmije e tetëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Nikolin Gojçi**.
9. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2023 të miratuar me VKB Nr 71 datë 27.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të

vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës” te ndryshuar , në programin P03280, Q1 O1 A2 “ Përbalimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë.

10. Për familjen e **Z. SAIMIR LAQJA , Znj. MRI MARKU , Z. PJETËR MHILLAJ dhe Z. NIKOLIN GOJÇI** kompensimi i dëmëve materiale ndërtimore sipas preventivave dhe në orendi e pajisje sipas vleresimit do të bëhet në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “ pika 3.1/a nga fondet e kushtëzuara që do të akordohen nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2023 për Bashkinë Shkodër sipas Relacionit bashkëngjitur në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **999 084 (nenteqind e nentedhjetë e nentemije e tetëdhjetë e kater) lekë** dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **579 490 (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë** .

11. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme në shumës prej 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë nga Buxheti i Bashkisë .

12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

13. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 11.4.2023